



KPM-2024/03

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, pika 6, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe Kapitullit VIII të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, KPM nxjerrë:

RREGULLORE PËR OBLIGIMET E OFRUESVE TË SHËRBIMEVE MEDIALE GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE

Kapitulli I Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore përcakton rolin, detyrat dhe përgjegjësitë e ofruesve të shërbimeve mediale gjatë fushatës zgjedhore në Republikën e Kosovës dhe përgjegjësitë e KPM-së në zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Kjo Rregullore zbatohet nga KPM ndaj të gjithë ofruesve të shërbimeve mediale, që bien nën juridiksionin e Komisionit të Pavarur të Mediave.
2. Kjo Rregullore zbatohet për monitorimin e ofruesve të shërbimeve mediale gjatë fushatës zgjedhore dhe heshtjes zgjedhore në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale, të rregullta apo të jashtëzakonshme, të cilat mbahen në Republikën e Kosovës.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **KPM** – Komisioni i Pavarur i Mediave.
 - 1.2. **KQZ** – Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - institucion i pavarur kushtetues, përgjegjës për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve.
 - 1.3. **OSHM** – ofrues i shërbimit medial - personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audio dhe audiovizuele të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.

1.4. **Transmetuesi Publik** – Radio Televizioni i Kosovës.

1.5. **Shkelje** – shkelja e Ligjit, Kushteve të Licencës, Kodit të Etikës, kësaj Rregulloreje apo akteve të tjera relevante të aplikueshme.

1.6. **Ankuesi** – parashtruesi i ankesës.

1.7. **Subjekti i ankesës** – subjekti nën juridiksionin e KPM-së, kundër të cilit parashtrohet ankesa apo zhvillohet procedura sipas detyrës zyrtare.

1.8. **Objekti i ankesës** – pretendimi ankimor për shkelje.

1.9. **Subjekt Politik** – parti politike, koalicion, nismë qytetare ose kandidat i pavarur.

1.10. **Subjekti(et) i certifikuar politik** – do të thotë subjekti politik, që është partia politike, koalicioni i partive politike, nisma qytetare ose kandidati i pavarur, i cili është i certifikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

1.11. **Periudha e fushatës** – do të thotë periudha e caktuar për fushatën zgjedhore të subjekteve politike, e cila përfundon me hapjen e qendrave të votimit në ditën e zgjedhjeve.

1.12. **Aktiviteti i fushatës politike** – do të thotë çfarëdo tubimi ose fjalimi politik, mbledhje, prezantim publik, ose ndonjë aktivitet i përgatitur për të propaganduar mesazh politik në lidhje me zgjedhjet.

1.13. **Pikë publicitare politike** – do të thotë një reklamë e vetme e natyrës politike që përfaqëson pikëpamjet e subjektit politik të certifikuar që transmetohet nga transmetuesi medial.

Kapitulli II **Obligimet e përgjithshme**

Neni 4 **Mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve**

1. Ofruesit e shërbimeve mediale (OSHM) obligohen t'i përmbahen Kreut VIII të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjit të KPM-së dhe akteve përkatëse nënligjore të KPM-së gjatë gjithë procesit të fushatës zgjedhore dhe ditës së votimit.

2. Programet e lajmeve duhet të mbulojnë fushatën dhe kandidatët në mënyrë të balancuar dhe të barabartë.

3. Transmetuesi publik është i obliguar të emetojë material për edukimin e votuesve pa pagesë. Materiali për edukimin e votuesve sigurohet nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

4. Të gjitha OSHM-të pranojnë reklamimin me pagesë në gjuhën(t) në të cilën ato normalisht transmetojnë ose publikojnë dhe në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

5. Reklamimi me pagesë bëhet në pajtim me kushtet, kriteret dhe procedurat e përcaktuara me Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe këtë Rregullore.

Neni 5

Qasja e drejtë dhe e paanshme nga mediat gjatë fushatës së zgjedhjeve

1. Trajtimi i të gjitha subjekteve të certifikuara politike bëhet në mënyrë të barabartë, pa marrë parasysh fuqinë e tyre politike.
2. Të gjitha OSHM-të në Kosovë zbatojnë dhe respektojnë në përpikëri parimet e trajtimit të barabartë dhe të balancuar, si dhe i trajtojnë në mënyrë të paanshme dhe të drejtë të gjitha subjektet e certifikuara politike.
3. OSHM-të gjatë raportimeve lidhur me procesin zgjedhor zbatojnë standardet më të larta që promovojnë integritetin e medias dhe gazetarëve, duke iu përmbajtur parimeve të saktësisë, drejtësisë, balancimit dhe barazisë, dhe duke zbatuar të drejtën për përgjigje apo zgjidhje ekuivalente në rastet kur ka pretendime për gabime gjatë raportimit.
4. OSHM-të sigurohen që të zbatojnë parimet e informimit të drejtë rreth procesit zgjedhor dhe mendimeve, qëndrimeve dhe platformave të të gjitha subjekteve politike, për të siguruar një ambient mediatik që i shërben procesit demokratik të zgjedhjeve. OSHM-të do të jenë të paanshme gjatë mbulimit të qëndrimeve dhe sjelljeve gjatë fushatës.
5. Fushata duhet të mbulohet në mënyrë të drejtë dhe të balancuar. Raportimi sasior mbi fushatën nuk duhet të reflektojë trajtim favorizues për ndonjë subjekt të certifikuar politik, duke përfshirë raportimin e barabartë dhe të balancuar për të gjitha subjektet politike.
6. OSHM-të ofrojnë informacione të rregullta rreth fushatës zgjedhore në mënyrë dhe kohë të barabartë për të gjitha subjektet e certifikuara politike.
7. OSHM-të iu sigurojnë subjekteve politike të certifikuara të drejtën të kenë mundësi të barabarta për t'u lidhur me publikun, si mjet për paraqitjen e ideve, mendimeve dhe programeve për të ardhmen e vendit.
8. OSHM-të përmes reklamimit politik me dhe pa pagesë duhet t'u mundësojnë subjekteve politike qasje të lirë dhe të drejtpërdrejtë tek votuesit në mënyrë që këta të fundit të kenë qasje tek platformat politike të kandidatëve dhe subjekteve politike të certifikuara.
9. OSHM-të, redaktorët dhe gazetarët mund të publikojnë komente apo qëndrime redaksionale dhe analitike, por ato duhet shprehimisht të ndahen nga faktet, respektivisht të njëjtat nuk duhet të raportohen si fakte.
10. OSHM-të gjatë fushatës zgjedhore në mënyrë proaktive promovojnë parimin e barazisë gjinore dhe të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë, qoftë përmes organizimit të debateve politike, debateve me ekspertë të pavarur apo mënyrave që mediat i konsiderojnë të përshtatshme dhe që nuk cenojnë këtë Rregullore apo Ligjin për Zgjedhjet.

Neni 6

Organizimi i skemës programore gjatë fushatës zgjedhore

1. Të gjitha OSHM-të mund të organizojnë programin e tyre gjatë fushatës zgjedhore sipas zgjedhjes së tyre dhe në përputhje me dispozitat e kësaj Rregulloreje.
2. OSHM-të të cilat vendosin të organizojnë programin e tyre gjatë fushatës zgjedhore do të deklarohen tek KPM nëse do të mbulojnë fushatën jo më larg se shtatë (7) ditë kalendarike para fillimit të fushatës zgjedhore.
3. Organizimi i programit duhet të sigurojë mbulim të fushatës zgjedhore në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të barabartë për të gjitha subjektet e certifikuara politike, pa marrë parasysh fuqinë e tyre politike.
4. Lajmet, intervistat, debatet, paraqitjet e lira politike, konventat dhe tubimet e subjekteve të certifikuara politike, hapja dhe mbyllja e fushatave nga subjektet politike, reklamimet politike me apo pa pagesë janë të gjitha forma përfaqësimi në media gjatë fushatës së zgjedhjeve dhe si të tilla do të trajtohen nga mediat.
5. OSHM-të prej ditës së parë të fushatës zgjedhore deri në ditën e fundit të fushatës zgjedhore, ndajnë orarin për aktivitetet e fushatës zgjedhore, i cili fillon nga ora 12:00 deri në ora 24:00.
6. Në kuadër të programeve informative nuk emetohet asnjë pikë reklamuese politike. Programet informative sipas këtij paragrafi përkufizohen si programe që zakonisht përfshijnë komponentët e sportit dhe të motit në transmetimet e lajmeve. Mos përfshirja e këtyre komponentëve jo domosdoshmërisht përjashton përmbajtjen nga cilësimi si programe informative.

Neni 7

Pika reklamuese politike

1. Pika reklamuese politike përkufizohet si një mesazh apo prezantim i shkurtër dhe i fokusuar që krijohet dhe transmetohet për të promovuar kandidatë, subjekte politike ose platforma të tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, e cila synon të ndikojë në opinionin publik dhe të nxisë mbështetje për subjektin politik që e transmeton.
2. Pika reklamuese politike nuk mund të jetë më e gjatë se dy (2) minuta (120 sekonda).
3. OSHM-të përkujdesen që çdo pikë reklamuese politike të identifikohet qartë si e tillë dhe të tregojë qartë organizatën ose individin përgjegjës për të.
4. Nuk lejohet përdorimi dhe prezenca e fëmijëve në spotet e ndryshme promovuese të partive politike.

Neni 8 Reklamimi politik pa pagesë

1. OSHM-të, të cilët vendosin të transmetojnë reklamim politik me pagesë kërkohet që gjatë periudhës së fushatës t'i ofrojnë një sasi minimale minutash të kohës për transmetim pa pagesë secilit subjekt politik të certifikuar:

- 1.1. dyzet (40) minuta për Transmetuesin Televiziv të Shërbimit Publik;
- 1.2. njëzet (20) minuta për transmetues televiziv privat që transmetojnë në tërë Kosovën;
- 1.3. pesëmbëdhjetë (15) minuta për të gjitha stacionet tjera televizive;
- 1.4. tridhjetë (30) minuta për secilin nga kanalet e dy radiove publike;
- 1.5. pesëmbëdhjetë (15) minuta për secilin radio stacion privat që transmeton në tërë Kosovën;
- 1.6. dhjetë (10) minuta për të gjitha radio stacionet tjera.

2. Obligimi sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk bie mbi OSHM-të, të cilët vendosin të mos transmetojnë reklamim politik me pagesë.

3. Së paku një (1) javë para fillimit të fushatës zgjedhore, bazuar në të dhënat e paraqitura nga KQZ-ja për subjektet e certifikuara politike, ofruesit e shërbimeve mediale publikojnë një orar me shkrim të kohës së paanshme dhe të drejtë të transmetimit pa pagesë për pikat reklamuese politike për të gjitha subjektet politike të certifikuara.

4. Reklama politike pa pagesë duhet t'u mundësojë subjekteve politike të certifikuara qasje të lirë dhe të drejtpërdrejtë tek votuesit.

5. Koha e emetimit pa pagesë si në paragrafin 1 të këtij neni, mund të sigurohet sipas vlerësimit të transmetuesve individual dhe pajtimit me subjektet e certifikuara politike, në formë:

- 5.1. si pika reklamuese politike pa pagesë;
- 5.2. pjesëmarrjes në debate,
- 5.3. programe diskutimi,
- 5.4. intervista jashtë programeve të rregullta informative të parapara.

6. OSHM-të iu sigurojnë dhe ofrojnë subjekteve të certifikuara politike në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe të balancuar mundësinë e emetimit pa pagesë gjatë kohës së ndarë për fushatën zgjedhore. Sigurimi i formës dhe kohës së emetimit pa pagesë nuk duhet të jetë favorizues për ndonjë subjekt të certifikuar politik.

7. Përfshirja në programet e rregullta informative të parapara nuk llogaritet si kohë emetimi pa pagesë.

8. OSHM-të nuk ndëshkohen nëse subjektet e certifikuara politike nuk shfrytëzojnë kohën e ofruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

9. OSHM-të që vendosin të transmetojnë reklamimet politike me pagesë, por që gjatë rrjedhës së periudhës së fushatës nuk ofrojnë minimumin e kohës së kërkuar për emetim pa pagesë për subjektet politike të certifikuara, konsiderohet se e kanë shkelur ligjin.

10. OSHM-të, të cilët vendosin të mos emetojnë reklamime politike me pagesë, por që ofrojnë kohë për emetim pa pagesë për cilindo subjekt politik të certifikuar, duhet që kohë të ngjashme për emetim pa pagesë t'u sigurojnë të gjitha subjekteve politike të certifikuara.

11. Kohëzgjatja sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk aplikohet në transmetimet sipas paragrafit 10 të këtij neni.

Neni 9

Reklamimi politik me pagesë

1. OSHM-të që ofrojnë reklama me pagesë duhet t'i përmbahen kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme.

2. Nëse reklama politike nuk identifikohet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me këtë Rregullore dhe Ligjin për Zgjedhjet, KPM do të urdhërojë ndalimin e menjëhershëm të transmetimit të asaj reklame deri sa të përmbushen kriteret e kërkuara.

3. OSHM-të të cilat zgjedhin të transmetojnë hapësira të paguara politike janë të obliguara të ofrojnë një javë para fillimit të periudhës së fushatës, një orar me shkrim të kohës së paanshme dhe të drejtë të emetimit me pagesë për të gjitha subjektet politike të certifikuara. Njoftimi duhet t'i dërgohet KPM-së të përmbajë sasinë e kohës së emetimit që transmetuesi mund t'ia shesë secilit subjekt politik gjatë fushatës zgjedhore.

4. Listat e çmimeve publikohen një javë para fillimit të fushatës:

4.1. Në ofertat që u bëhen subjekteve politike;

4.2. Në uebfaqet e mediave;

4.3. KPM publikon në formë tabelare dhe të përmbledhur listën e plotë të OSHM-ve që janë deklaruar të mbulojnë fushatën zgjedhore së bashku me çmimet që ato ofertojnë.

5. Koha e emetimit të reklamimit politik mund të konsumohet në formë të pikave reklamuese dhe materialeve të sponsorizuara.

6. OSHM-të nuk ndëshkohen nëse një subjekt politik i certifikuar nuk e shfrytëzon kohën e ofruar në mënyrë të drejtë dhe të paanshme.

7. Hapësira që transmetuesit mund t'ua shesin të gjitha subjekteve politike për reklamim politik është gjashtë (6) orë brenda periudhës së përcaktuar në nenin 6 paragrafi 5.
8. Hapësirën për reklamim si në paragrafin 7, transmetuesit ua ofrojnë në mënyrë të barabartë të gjitha subjekteve të certifikuara.
9. Kufiri sasior i kohës së emetimit politik për një subjekt të certifikuar politik brenda një dite është 90 minuta.
10. Brenda kësaj periudhe, koha e ofruar për emetim politik për të gjitha subjektet e certifikuara politike që ofrojnë materiale në gjuhën që OSHM transmeton duhet të jetë e barabartë dhe e balancuar për kohën prime time dhe kohë të tjera.
11. Çmimi për një sekondë me të cilin ngarkohen për pika reklamuese politike me pagesë nuk është më i lartë sesa shkalla më e ulët e ngarkuar për atë kohë dhe ditë të javës gjatë gjashtë (6) muajve të fundit.
12. Lista e çmimeve për një sekondë publikohet së bashku me njoftimin sipas paragrafit 3 të këtij neni.
13. Reklamimi me ekran të ndarë, tele-promocioni, radio-promocioni dhe reklamimi virtual nuk mund të përdoren si forma të komunikimit komercial politik.

Neni 10

Rregullat e përgjithshme lidhur me komunikimet komerciale politike

Të gjitha rregullat dhe parimet e përgjithshme që zbatohen për komunikimet komerciale audiovizuale për sa u përket standardeve të cilat ato duhet të përmbushin dhe ndjekin gjatë transmetimit të komunikimit komercial vlejnë edhe për komunikime komerciale politike, ashtu siç është përcaktuar me Rregulloren KPM 2023/02 për Komunikimet Komerciale Audio dhe Audiovizuale.

Neni 11

Mbajtja e ditarëve

1. OSHM-të do të mbajnë ditarë të veçantë ditorë për qasjet e siguruara pa pagesë dhe kohët për reklamim që i janë shitur çdo subjekti politik të certifikuar.
2. Format e ditarëve me të dhënat që duhet të përmbajnë ditarët, sigurohen nga KPM.
3. Ditarët dorëzohen të hënën e secilës javë për të raportuar për javën paraprake.
4. Ditarët janë të hapur për publikun.
5. Forma e ditarëve i bashkëngjitet kësaj Rregulloreje.

Neni 12

Emisionet dhe debatet politike

1. Debatet politike ku bëhet prezentimi i platformave politike nga subjektet e certifikuara politike organizohen në atë mënyrë ku secili medium e publikon orarin e debateve politike lidhur me temat që do të jenë subjekt i debatit dhe subjekteve politike që do të marrin pjesë.
2. Debatet politike gjatë fushatës zgjedhore do të organizohen në atë mënyrë, duke ndarë kohën e njëjtë dhe të barabartë për secilin subjekt të certifikuar politik, pa marrë parasysh fuqinë e përfaqësimit të tyre politik.
3. Gjatë emisioneve apo debateve politike, udhëheqësit e emisioneve do të ndajnë dhe mundësojnë kohën e barabartë për secilin subjekt të certifikuar politik, duke e ndarë në minuta të barabartë për secilin subjekt politik për t'i shprehur dhe mbrojtur qëndrimet e tyre politike.
4. Në debate politike që ndërlidhen me fushatën zgjedhore kur ka përfaqësues të disa subjekteve të certifikuara politike, ndahet koha e barabartë e minutazhës sipas subjektit të certifikuar politik.
5. Koha dhe orari i ndarë për kandidatët e subjekteve politike, llogaritet kohë e ndarë për subjektin e certifikuar politik.
6. OSHM-të nuk mbajnë përgjegjësi nëse koha e ndarë për një subjekt të certifikuar politik nuk shfrytëzohet.
7. Emisionet apo debatet politike nuk do të jenë të sponsorizuara nga subjekte të certifikuara politike apo subjekte tjera.

Neni 13

Publikimi i sondazheve

1. Ndalohet organizimi, publikimi i sondazheve apo anketave të opinionit publik online në programet e OSHM-ve gjatë fushatës zgjedhore dhe ditën e zgjedhjeve.
2. OSHM-të që publikojnë hulumtime të opinionit publik dhe anketa gjatë fushatës zgjedhore dhe që kanë të bëjnë me zgjedhjet obligohen të tregojnë:
 - 2.1. numrin e gjithmbarshëm të respondentëve që kanë marrë pjesë në hulumtim;
 - 2.2. metodologjinë e hulumtimit të opinionit publik apo anketës;
 - 2.3. emrin e kompanisë realizuese;
 - 2.4. emrin e partisë apo organizatës që ka kërkuar apo financuar për hulumtimin e opinionit publik apo anketës dhe;
 - 2.5. margjinën e gabimit.

3. OSHM-të sigurohen të mos publikojnë sondazhe, hulumtime të opinionit publik apo anketa të paverifikuara dhe që nuk plotësojnë standardet.

4. OSHM-të nuk publikojnë sondazhe apo anketa gjatë fushatës zgjedhore të kryera nga kompanitë apo organizatat që bëjnë hulumtime të opinionit publik dhe që nuk zbatojnë rregullat e etikës, përdorin metodologji të anshme, kampionë që i referohen vetëm një rajoni të caktuar, pyetje sugjestive që drejtojnë përgjigjen apo elemente të tjera që cenojnë besueshmërinë e tyre.

5. Asnjë OSHM nuk transmeton asnjë publikim ose transmetim të rezultateve të hulumtimit të opinionit publik që ka të bëjë me fushatën e zgjedhjeve, duke përfshirë daljen në votime, gjatë periudhës që fillon njëzet e katër (24) orë para mbylljes zyrtare të vendotimeve dhe deri në përmbylljen e procesit zgjedhor.

Neni 14

OSHM-të në ditën e zgjedhjeve

1. Asnjë OSHM nuk transmeton ose publikon çfarëdo materiali që i takon aktivitetit të fushatës, gjatë periudhës që fillon me hapjen e vendotimeve deri në mbylljen zyrtare të tyre.

2. OSHM-të vazhdojnë mbulimin e ditës së zgjedhjeve për të raportuar dhe informuar publikun lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, numrin e pjesëmarrësve në zgjedhje, njoftimet zyrtare nga KQZ-ja apo institucionet e tjera relevante, problemet e mundshme apo sjelljet e partive apo pjesëmarrësve në zgjedhje.

3. OSHM-të raportojnë dhe informojnë publikun lidhur me parregullsitë eventuale të procesit zgjedhor, individët e përfshirë në incidente gjatë ditës së zgjedhjeve, fotografi, materiale zanore, apo pamore që kanë të bëjnë me pjesëmarrësit në zgjedhje dhe sjelljen e tyre, dhe çdo parregullsi tjetër që lidhet me fushatën zgjedhore ditën e votimit.

4. OSHM-të gjatë ditës së zgjedhjeve dhe deri në mbylljen e vendotimeve nuk transmetojnë prononcimet e kandidatëve nga listat për deputetë apo asamblistë me përjashtim të liderëve të partive politike dhe kandidatëve për kryeministër apo kryetar të komunës.

Neni 15

Parandalimi i konfliktit të interesit

Gazetarët, redaktorët, udhëheqësit e transmetimeve dhe pronarët e mediave që kandidohen në zgjedhje për një post publik, nuk kontribuojnë ose përndryshe ndikojnë në përmbajtjen e mediave të tyre përkatëse.

Neni 16

Monitorimi i ditave nga KPM

1. Komisioni i Pavarur i Mediave siguron se OSHM-të mirëmbajnë dhe dorëzojnë ditarin sipas nenit 11 të kësaj Rregulloreje.

2. Ditarët e dorëzuar nga OSHM-të verifikohen, kontrollohen dhe vlerësohen nga KPM.
3. KPM ndërmerr masa sanksionuese ndaj të gjithë OSHM-ve të cilët nuk dorëzojnë ditarët apo nuk i plotësojnë ditarët, siç parashihet me nenin 11 të kësaj Rregulloreje.
4. OSHM-të njoftojnë KPM-në vazhdimisht për përmbushjen e obligimeve të kësaj Rregulloreje.
5. KPM në vazhdimësi njofton publikun në lidhje me zbatimin e kësaj Rregulloreje nga KPM dhe OSHM-të.

Neni 17

Monitorimi i zbatimit të Rregullores

Përtej obligimeve të përcaktuara me Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me këtë Rregullore, KPM ndërmerr masa të veçanta për monitorimin e zbatimit të dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 18

Shkelja e dispozitave të Rregullores

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje konsiderohet shkelje dhe sanksionohet nga KPM, sipas sanksioneve të përcaktuara me Ligj të KPM-së.

Neni 19

Trajtimi i ankesave

1. Procedura e trajtimit të ankesave për shkelje të kësaj Rregulloreje zhvillohet në përputhje me Rregulloren për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM.
2. Lidhur me ankesat për shkelje të dispozitave të kësaj Rregulloreje, KPM aplikon afate të shkurtuara kohore, sipas nenit 20 të kësaj Rregulloreje.

Neni 20

Procedura ankimore dhe afatet lidhur me trajtimin e ankesave

1. Të gjitha ankesat përkitazi me pretendimet për shkelje nga mediat të obligimeve të përcaktuara në këtë Rregullore dhe Ligjin nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme shqyrtohen në përputhje me Rregulloren për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM dhe afatet specifike të përcaktuara me këtë Rregullore.
2. Shqyrtimi i ankesave dhe vendimi i KPM-së duhet të përfundojë më së largu brenda pesë (5) ditëve nga momenti i pranimit të ankesës gjatë fushatës së rregullt zgjedhore. Në rastet e zgjedhjeve të jashtëzakonshme ky afat shkurtohet në gjashtëdhjetë (60) orë.
3. Shqyrtimi fillestar i ankesave, sipas nenit 13 të Rregullores për Procedurën e Trajtimit të Ankesave në KPM, bëhet brenda katër (4) orëve nga momenti i pranimit të ankesës.

4. Afati i OSHM-së për përgjigje në ankesë është njëzet e katër (24) orë nga momenti i pranimit të ankesës.

5. Shqyrtimi i ankesës sipas nenit 18 të Rregullores për Procedurën e Trajtimin të Ankesave në KPM përfundon brenda njëzet e katër (24) orëve pas përgjigjes në ankesë apo skadimit të afatit për ankesë.

6. Në rastin e zgjedhjeve të rregullta, jo më vonë se brenda dyzet e tetë (48) orëve, KPM mbanë takim për të shqyrtuar rekomandimin e Zyrës Ekzekutive përkitazi me ankesën e parashtruar. Në rastet e zgjedhjeve të jashtëzakonshme KPM shqyrton rekomandimin e Zyrës Ekzekutive brenda njëzet e katër (24) orëve.

7. Vendimet e miratuara KPM ua dërgon palëve dhe bëhen publike jo më larg se njëzet e katër (24) orë nga marrja e tyre.

Neni 21

Publikimi i raportit përfundimtar nga KPM

KPM harton dhe publikon raport përfundimtar mbi procesin e parashtrimit dhe shqyrtimit të ankesave, duke përfshirë edhe vendimet dhe gjobat e shqiptuara për OSHM-të.

Neni 22

Zbatimi i Rregullores

1. Kjo Rregullore zbatohet nga KPM në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave.

2. Çështjet për të cilat kjo Rregullore nuk ka paraparë dispozita të veçanta mbulohen përmes dispozitave të Kapitullit VIII të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjit për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe aktet normative të nxjerra nga KPM.

Neni 23

Masat e veçanta për zbatimin e Rregullores

1. Në mënyrë që të mundësohet zbatimi i dispozitave të kësaj Rregulloreje sipas afateve të parapara në këtë Rregullore, KPM do të ndër marrë masa të veçanta.

2. Masat e veçanta sipas paragrafit 1 të këtij neni hyjnë në fuqi një javë para fillimit të fushatës zgjedhore dhe përfundojnë pas mbylljes së procesit zgjedhor.

3. Masat e veçanta për zbatimin e Rregullores përfshijnë, por nuk kufizohen në:

3.1. Ndalimin e pushimit vjetor për të gjithë anëtarët e KPM-së dhe stafin përgjegjës për zbatimin e Rregullores;

3.2. Mbajtjen e takimeve online, në rastet kur për shkaqe të jashtëzakonshme pamundësohet pjesëmarrja në takimet e KPM-së;

- 3.3. Votimi elektronik, përmes emailave zyrtare;
- 3.4. Prioritizimin e zbatimit të kësaj Rregulloreje në raport me të gjitha çështjet e tjera në kompetencë të KPM-së;
- 3.5. Lëvizjen e stafit brenda KPM-së për nevojat e zbatimit të kësaj Rregulloreje;
- 3.6. Angazhim të stafit nga jashtë institucionit me afat të caktuar lidhur me monitorimin e procesit zgjedhor.
4. Masat e veçanta për zbatimin e Rregullores të përcaktuara me paragrafin 3 të këtij neni vlejné dhe janë të aplikueshme vetëm gjatë kohës së zgjedhjeve dhe nuk mund të zbatohen dhe të kenë efekt ligjor pas mbylljes së procesit zgjedhor.

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi datën e miratimit.


Jeton Mehmeti
Kryetar i KPM-së



16.12.2024
Datë

Shtojca 1

Reklamimet politike pa pagesë					
<i>Ditari A</i>					
	Subjekti i certifikuar politik	Data	Koha e fillimit	Koha e ofruar (sekonda)	Emri i programit
1					
2					
3					
4					
5					
6					
7					
8					
9					
10					
11					
12					
13					
14					
15					
16					
17					
18					
19					
20					
21					
22					
23					
24					
25					
26					
27					
28					

Reklamimet politike me pagesë						
<i>Ditari B</i>						
	Subjekti i certifikuar politik	Data	Koha e fillimit	Koha e ofruar (sekonda)	Çmimi për sekondë	Emri i programit
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
12						
13						
14						
15						
16						
17						
18						
19						
20						
21						
22						
23						
24						
25						
26						
27						
28						